procedures se prokurimit objekt ankimi. Akoma me tej ne nenin 20 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre. Ne rastin konkret, vleresojme se kriteri i mesiperm eshte diskriminues pasi diskriminon ne menyre te drejtperdrejte mes operatoreve ekonornike te cilet shfaqen ne cilesine e thertores qe kane magazina per perpunimin e mishit si edhe te furnitoreve. Akoma me tej, eshte kerkuar qe magazina te disponohet me siperfaqen e mesiperme per magazinimin e produkteve te mishit te perpunuara, nderkohe qe referuar sasise dhe grafikut te levrimit eshte kerkuar vetem nje lloj mishi, mish vici e cilesise se pare.

Referuar aktit mbi kthim pergjigje, autoriteti kontraktor nuk ka dhene asnje argument teknik mbi faktin se perse nevojtet nje siperfaqe prej 100 m2 ku referuar specifikimeve teknike, sasia maksimale ditore eshte 500 kg (e pritshme) dhe njekohesisht kerkohet qe mishi te jete i fresket, pra kapaciteti maksimal qe mund te rnbaje magazina eshte 500 kg mish, ku referuar te gjithe standardeve ne fuqi, siperfaqja eshte e ekzagjeruar. Ne kthim pergjigje autoriteti sqaron se Kriteret e vecanta per kualifikim kane si synim kryesor qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedural e prokurimit. Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme bazuar dhe ne piken 1, te nenit 46 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe Jodiskriminuese ... "

Sa me siper, sqarojme se, Organi Qendror Bleres percakton kerkesat e vecanta te kualifikimit duke i argumentuar ato si dhe duke marre parasysh objektin, vleren, specifikat, sipas parashkimeve ligjore ne fuqi.

Ne nenin 27 pika 3 te Vendimit br. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar parashikohet se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesm operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve." Sa me siper, autoriteti kontraktor nuk ka dhene asnje argument teknik mbi nevojen e disponueshmrise se nje magazine prej 100 m2, ndaj kerkojme qe kjo siperfaqe te ndryshohet ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi, ku ne vleresimin tone siperfaqja maksimale e kerkuar nuk duhet te kaloje 60 m2.

2. Ne shtojcen 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", Loti, 3, 4, 6 te dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi eshte parashikuar:
Loti 3
1) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes Licence te kategorise "II.1.A.1- Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", per perpunimin ose tregtimin e produkteve te mishit/ te perpunuara te mishit, ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kornbetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018).
2) Operatori ekonomik pjesernarres, ne rast se eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14. 7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar).
3) Operatori ekonomik pjesemarres, ne rast se nuk eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit C (kodi III.1.A) per magazinimin frigoriferik te produkteve ushqimore te ambalazhuara, e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14. 7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar).
Ne nenin 46 pika 1 germa "b" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;
Ne interpretim literal dhe sistematik te nenit 46 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, kriteret e vecanta per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton dhe kerkesat e vecanta per kualifikim, duke mbajtur ne konsiderate kufijte maksimal te percaktuara ne rregullat e prokurimit publik. Pra ne thelb kriteret e vecanta te kualifikimit percaktohen, nga Autoriteti Kontraktor, ne perpjestim me natyren, qellimin, rnadhesine, volumin dhe filozofine e kontrates perkatese.
Konkretisht, ne lidhje me kerkesen e parashikuar ne shtojcen 9 "Kriteret e vecanta te kualifikimit" te lotit 3 ku parashikohet se: "Operatori ekonomik pjesemarres, ne rast se nuk eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit C (kodi III.1.A) per magazinimin frigoriferikte produkteve ushqimore te ambalazhuarat, e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14. 7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar). Referuar ligji Nr. 60/2014 PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR. 10448, DATE 14.7.2011, "PER LEJET E MJEDISIT", TE NDRYSHUAR parashikohet se Leje rnjedisit e tipit C per magazinimin

frigoriferik te produkteve ushqimore te ambalazhuara, zbatohet vetem Per magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tone. Referuar shtojces 12 sasia e pritshme e furnizimit me mish eshte 359,890 kg per 24 muaj e cila eshte e barabarte me 14,995 kg ne muaj, si edhe duke marr ne konsiderate specifikimet teknike dhe sasine e nevojshme ditore dhe faktin qe mishi duhet te jete i fresket, i bie me furnizim ditor rreth 500 kg per rrjedhoje siperfaqja prej 100 m2 ne te cilen do te magazinohet sasi ditore vetem 500 kg eshte ekzagjeruar dhe aspak ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, kapaciteti maksimal mujor eshte rreht 15 ton ndersa ditor rreth 500 kg, per rrjedhoje kerkesa per disponimin e licecnes per magazinim frigoriferik te produkteve ushqimore, ne kushte kur kjo Iicecne referuar legjislacionit sektorial shfaqet e nevojshme vetem per magazinimin me kapacitet mb 20 ton, pra me e ulet se sa kapaciteti mujori kerkuar dhe per rrjedhoje nuk eshte aspak ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi.

Referuar aktit mbi trajtimin e ankeses, autoriterti kontraktor ka argumentuar se: "Kriteri i sipercituar eshte kerkuar ne zbatim te germes "a" pika I nenit 46, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku percaktohet se: "I. Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kuali.fikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato Jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata; .. " si dhe referuar Rekomandimit te perbashket Nr.10181 Prot., APP dhe Nr. 8514 Prot., AKU

Ne VKM nr.538, date 26.5.2009, Aneksi I Fusha III "Mjedisi dhe burimet Mjedisore Baze" ne kategorine III.1 "Per ndikimin ne mjedise" Jane percaktuar dhe nenkategorite perkatese ku perfshihen a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III.I.A; b) "leje mjedisore" me kodin III.I.B; c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III I.C.

Ne kriterin e percaktuar eshte bere shenimi se Leja mjedisore duhet te jete sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar. Ne shojcen nr 1 ne nr e ID 7.7 "Prodhimi i ushqimeve i pijeve dhe i veprimtarive te lidhura me to", eshte percaktuar qarte leja mjedisore, ne lidhje me kapacitete prodhuese.

Organi Qendror Bleres per te mundesuar dhe pjesemarrjen e subjekteve qe Jane thjesht tregtuese te produkteve objekt prokurimi do te publikoje ne sistemin e prokurimit elektonik nje shtojce ku te shtoje ne kriterin e percaktuar ne shtojcen 9, seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" pika 2 te saktesoje se lejet mjedisore te percaktuara ne kete kriter do te kerkohen ne rastet kur operatori ekonomik eshte prodhues. "

Edhe ne rastin konkret, edhe ne hipotezen se operatori ekonomik eshte vete prodhues, serish kerkesa e lejes se mesiperme nuk eshte e mbeshtetur ne ligj dhe vecanerisht ne legjislacionin sekktorial mbi kapacitetet kufi te lejes pasi referuar ligjit Nr. 60/2014 PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR. 10448, DATE 14.7.2011, "PER LEJET E MJEDISIT", TE NDRYSHUAR parashikohet se Leje mjedisit e tipit C per magazinimin frigoriferik te produkteve ushqimore te ambalazhuara, zbatohet vetem Per magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tone, ndersa referuar sasise se pritshme ditore kjo e fundit parashikohet ne rreth 500 kg ne dite dhe rreth 15 ton ne muaj, pra me pak se 20 ton. Duhet te kemi parasysh qe duke marre ne konsiderate natyren e furnzimit

(mish) qe kerkohet te jete i fresket kapaciteti maksimal qe mund te mbaje magazine eshte ajo nje ditore, pra vetem 500 kg, ndaj kerkesa per leje te tipit C nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit duke rene ne kundershtim me nenin 46 te LPP.

Ne lidhje me kerkesen per Licence te kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", per perpunimin ose tregtimin e produkteve te mishit/ te perpunuara te mishit, ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018). Vleresojme se ne nenin 20 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre. Vleresojme se kriteri i mesiperm perben diskriminim te drejtperdrejte mes furizueve dhe kontraktoreve te tyre duke kerkuar qe nuk lejohet perdorimi I licences se nje operatori ekonomik tjeter. Ne rastin konkret vleresojme se kerkesa e mesiperme nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit. Gjithashtu, kriteri i mesiperm nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit si edhe nuk lidhet drejtperdrejte me objektin e procedures se prokurimit objekt ankimi.

Referuar aktit mbi kthim pergjigje autoriteti kontraktor ka argumentuar se: "Per sa me siper, organi qendror bleres do te publikoje ne sistemin e prokurimit elektonik nje shtojce ku te shtoje ne kriterin e percaktuar ne shtojcen 9, seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" pika 1 edhe licencen II.1.B. Persa me siper, pretendimi i ankimuesit "Olta Sharra" PF pranohet dhe ndryshimi i kriterit te behet publik per te gjithe operatoret ekonomik te interesuar me ane te publikimit te nje shtojce ne sistemin e prokurimit elektronik.

Ne rastin konkret, sqarojme se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar asnje shtojce dhe se pari nuk eshte e qarte nese do te ndryshohet duke u hequr kerkesa e mesiperme apo duke u shtuar edhe nje kerkese tjeter, Per Licencen II.1.B. Theskojme se kerkesa jone eshte lidhur ngushtesisht me heqjen e Licences se kategorise II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez".

-Ne lidhje me kerkesen nese operatori ekonomik pjesemarres, ne rast se eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit ", te ndryshuar) sqarojme se kerkesa e mesiperme eshte ne kundershtim me nenin nenin 20 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre pasi autoriteti kontraktor po diskriminon ne menyre te drejtperdrejte mes kategorive te operatoreve ekonomike, furnitoreve dhe kontraktoreve te tyre, Akoma me tej, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje qarte natyren e lejes se kerkuar, pasi ne te kundert, shkel nje nder parimet baze te zhvillimit te procedurave ate te trajtimit te barabarte mes kerkesave per operatoret ekonomike sic parashikohet edhe ne nenin 2 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar duke lejuar qe operatore ekonomike te dorezojne dokumentacione te ndryshme dhe te kualifikohen njekohesisht.

Referuar aktit mbi trajtimin e ankeses, kerkesa e mesiperme nuk eshte trajtuar nga autoriteti kontraktor, ndaj kerkojme shqyrtimin ne theme! nga Komisioni i Prokurimit Publik.

II.5. Në datën 16.04.2020, nëpërmjet shkresës nr. 591/1 Prot., datë 14.04.2020, me objekt *"Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: "Berje artikuj ushqimorë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjve", e ndarë në 6 Lote, konkretisht për Lotin 3",* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit *"Sa me siper, autoriteti kontraktor nuk ka dhene asnje argument teknik mbi nevojen e disponueshmrise se nje magazine prej 100 m2, ndaj kerkojme qe kjo siperfaqe te ndryshohet ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi, ku ne vleresimin tone siperfaqja maksimale e kerkuar nuk duhet te kaloje 60 m2"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 9, pika 2.3.4, "Kapaciteti teknik", është përcaktuar kriteri si më poshtë:

1) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për përpunimin ose tregtimin ose magazinimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 100 m^2, për të cilin duhet të paraqes dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

➢ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➢ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë noteriale huapërdorje.*

➢ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë noteriale qiraje.*

b) Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë ambient.

d) Foto të ambientit të brendshëm të përpunimit ose tregtimit ose magazinimit, të produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit, objekt prokurimi.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", është përcaktuar si më poshtë:

➢ *Për Loti 3 - "Blerje mish dhe nënprodukte të tij për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve"*

Nr.	*Emërtimi i artikujve ushqimorë*	*Njësia matëse*	*Sasitë e pritshme*
1	*Mish Viçi, cilësi e parë*	*Kg*	*359890*

III.1.3. Në dokumentat e Specifikimet teknike", është përcaktuar si më poshtë:

LOTI 3 - "BLERJE MISH DHE NËNPRODUKTET E TIJ"

1. MISH VIÇI

Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre".

Klasifikimi:

- *I freskët, cilësia e parë*

Kërkesat cilësore

Mishi përgatitet në gjysmë trupi dhe në çerek. Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebrave të shtyllës kurrizore, duke lënë në njërën anë palcën e kurrizit. Ndarja e gjysmë trupave në çerekë bëhet nëpërmjet brinjës 12 dh 13 dhe nëpërmjet brinjës 7 dhe 8 kur mishi i nënshtrohet ndarjes anatomike. Koka pritet nëpërmjet kockave të qafës dhe të vertebrës së parë të qafës(atlanti) këmbët te kyçet e gjurit, kurse bishti pritet nëpërmjet vertebrës së parë e të dytë të tij. Organet e brendshme, përveç veshkave, veçohen.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme: Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Tendinat janë të shëndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shëndritshme. Lëngu është i tejdukshëm.*
- *Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa qe ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.*
- *Era: e këndshme , karakteristikë e llojit.*
- *Palca e kockave : Mbush plotësisht kanalin e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë. Në prerje është e shëndritshme.*
- *Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.*
- *Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.*

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Azot i tretshëm, mg, amoniak (NH_3)/100 gr produkt jo më shumë se 20.*

- *Aciditeti i shprehur në pH: 5.2 deri 6.4.*
- *Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H_2S): Negativ.*
- *Reaksioni Kreis: Negativ.*
- *Ngarkesa mikrobike: Brenda normave te miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.*

Treguesit kimikë dhe mikrobikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme, këmbë dhe kokë.

Ambalazhimi dhe markimi

Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit.

Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje.

Tregtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.

Mishi duhet te theret ne ambiente (thertore të licencuara), të cilat plotësojnë standardet higjeno – sanitare dhe veterinare.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-ricikluesshme dhe të shoqëruara me çertifikatë konformiteti.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Ambalazhet duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti, e cila përfaqëson sasinë e mishit e të njëjtit lloj i therur në të njëjtën thertore dhe që dorëzohet njëherësh.

Kontrolli veterinar dhe sanitar i mishit bëhet sipas ligjit në fuqi "Mbi shërbimin veterinar".

Mishi të jetë i cilësisë së parë, i shoqëruar me certifikatë veterinare sipas ligjeve ne fuqi.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.

Mishi i viçit te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me Certifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Ruajtja dhe transportimi

Mishi ruhet në kushte frigoriferike.

Në gjendje të ftohur ruhet në temperature nga 0 deri në -1 °C, me lagështirë relative 90-95 %, deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në +4 °C deri në 5 ditë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

III.1.4. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se: *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që*

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: *a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

III.1.5. Në nenin 28 pika 5 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Rregullat e Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

"5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose."

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proprocion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kritereve të kualifikimin.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *"2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik"*

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi sipërfaqen e ambientit të përshtatshëm për përpunimin ose tregtimin ose magazinimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit objekt prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë si kriter minimumin e sipërfaqes të ambientit të domosdoshëm, në mënyrë që të sigurohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës disponojnë ambiente me hapësira të tilla që garantojnë kryerjen e furnizimit në kohën dhe sipas volumeve të përcaktuara. Por, referuar volumeve të parashikuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, Komisioni gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se minimumi i sipërfaqes të ambientit duhet të jetë 100 m2, është një kërkesë e ekzagjeruar e cila nuk është në përpjestim me volumin e parashikuar të shërbimit objekt kontrate. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter, duke e ulur kufirin minimal të sipërfaqes për ambientin ku do të kryhet shërbimi objekt prokurimi në përputhje me volumin e objektit të kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit *“Konkretisht, ne lidhje me kerkesen e parashikuar ne shtojcen 9 "Kriteret e vecanta te kualifikimit" te lotit 3 ku parashikohet se: "Operatori ekonomik pjesemarres, ne rast se nuk eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit C (kodi III.1.A) per magazinimin frigoriferikte produkteve ushqimore te ambalazhuarat, e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14. 7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar). Referuar ligji Nr. 60/2014 PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR. 10448, DATE 14.7.2011, "PER LEJET E MJEDISIT", TE NDRYSHUAR parashikohet se Leje rnjedisit e tipit C per magazinimin frigoriferik te produkteve ushqimore te ambalazhuara, zbatohet vetem Per magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tone. Referuar shtojces 12 sasia e pritshme e furnizimit me mish eshte 359,890 kg per 24 muaj e cila eshte e barabarte me 14,995 kg ne muaj, si edhe duke marr ne konsiderate specifikimet teknike dhe sasine e nevojshme ditore dhe faktin qe mishi duhet te jete i fresket, i bie me furnizim ditor rreth 500 kg per rrjedhoje siperfaqja prej 100 m2 ne te cilen do te magazinohet sasi ditore vetem 500 kg eshte ekzagjeruar dhe aspak ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, kapaciteti maksimal mujor eshte rreht 15 ton ndersa ditor rreth 500 kg, per rrjedhoje kerkesa per disponimin e licecnes per magazinim frigoriferik te produkteve ushqimore, ne kushte kur kjo Iicecne referuar legjislacionit sektorial shfaqet e nevojshme vetem per magazinimin me kapacitet mb 20 ton, pra me e ulet se sa kapaciteti mujori kerkuar dhe per rrjedhoje nuk eshte aspak ne proprocion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 9, pika 2.1.3, "Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë", është përcaktuar kriteri si më poshtë:

1) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, <u>në rast se nuk është thertore</u>, duhet të paraqes Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A) për magazinimin frigoriferik të produkteve ushqimore të ambalazhuara, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar).*

III.2.2. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", është përcaktuar si më poshtë:

- *Për Loti 3 - "Blerje mish dhe nënprodukte të tij për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve"*

Nr.	*Emërtimi i artikujve ushqimorë*	*Njësia matëse*	*Sasitë e pritshme*
1	*Mish Viçi, cilësi e parë*	*Kg*	*359890*

III.2.3. Në dokumentat e Specifikimet teknike", është përcaktuar si më poshtë:

<u>LOTI 3 - "BLERJE MISH DHE NËNPRODUKTET E TIJ"</u>

2. MISH VIÇI

Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre".

Klasifikimi:

- *I freskët, cilësia e parë*

Kërkesat cilësore

Mishi përgatitet në gjysmë trupi dhe në çerek. Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebrave të shtyllës kurrizore, duke lënë në njërën anë palcën e kurrizit. Ndarja e gjysmë trupave në çerekë bëhet nëpërmjet brinjës 12 dh 13 dhe nëpërmjet brinjës 7 dhe 8 kur mishi i nënshtrohet ndarjes anatomike. Koka pritet nëpërmjet kockave të qafës dhe të vertebrës së parë të qafës(atlanti) këmbët te kyçet e gjurit, kurse bishti pritet nëpërmjet vertebrës së parë e të dytë të tij. Organet e brendshme, përveç veshkave, veçohen.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme: Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Tendinat janë të shëndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shëndritshme. Lëngu është i tejdukshëm.*
- *Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa qe ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.*
- *Era: e këndshme , karakteristikë e llojit.*
- *Palca e kockave : Mbush plotësisht kanalin e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë. Në prerje është e shëndritshme.*
- *Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.*

- *Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.*

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Azot i tretshëm, mg, amoniak (NH_3)/100 gr produkt jo më shumë se 20.*
- *Aciditeti i shprehur në pH: 5.2 deri 6.4.*
- *Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H_2S): Negativ.*
- *Reaksioni Kreis: Negativ.*
- *Ngarkesa mikrobike: Brenda normave te miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.*

Treguesit kimikë dhe mikrobikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme, këmbë dhe kokë.

Ambalazhimi dhe markimi

Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit.

Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje.

Tregtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.

Mishi duhet te theret ne ambiente (thertore të licencuara), të cilat plotësojnë standardet higjeno – sanitare dhe veterinare.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-ricikluesshme dhe të shoqëruara me çertifikatë konformiteti.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Ambalazhet duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti, e cila përfaqëson sasinë e mishit e të njëjtit lloj i therur në të njëjtën thertore dhe që dorëzohet njëherësh.

Kontrolli veterinar dhe sanitar i mishit bëhet sipas ligjit në fuqi "Mbi shërbimin veterinar".

Mishi të jetë i cilësisë së parë, i shoqëruar me certifikatë veterinare sipas ligjeve ne fuqi.

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.

Mishi i viçit te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me Certifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.

Ruajtja dhe transportimi

Mishi ruhet në kushte frigoriferike.

Në gjendje të ftohur ruhet në temperature nga 0 deri në -1 °C, me lagështirë relative 90-95 %, deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në +4 °C deri në 5 ditë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat

higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

III.2.4. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se: *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*: *a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

III.2.5. Në nenin 28 pika 5 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Rregullat e Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

"5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose."

III.2.6. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", në nenin 1 dhe 2 "*Qëllimi dhe Objekti*", parashikohet shprehimisht:

"Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës".

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë."

III.2.7. Në neni 4 "*Sistemi i lejeve të mjedisit*" të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", parashikohet shprehimisht:

"*1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:*

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji."

III.2.8. Në shtojcën 1 *"Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi"* të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", përcaktohet:

"Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo".

III.2.9. Në ligjin Nr. 60/2014 *"Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit"*, të ndryshuar, parashikohet:

SHTOJCA 1 LEJET E MJEDISIT TË TIPAVE A, B DHE C NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES KUFI SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT A

Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore	Kapaciteti prodhues i karkasave është më i madh se 50 tonë/ditë	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq, por gjithsesi më shumë se 5 tonë/ditë	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 5 tonë në ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce.	Kapaciteti i trajtimit është më i madh se 10 tonë/ditë të karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë	Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.	--------
		c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 75 tonë në ditë	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 75 tonë në ditë ose më pak se kaq, por më shumë se 5 tonë/ditë	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 5 tonë/ditë ose më pak
		d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 300 tonë në ditë (vlerë mesatare duke u bazuar në të dhëna trimestrale).	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 300 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat trimestrale), por më shumë se 10 tonë/ditë.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak.
		e. Trajtimi dhe përpunimi i qumështit	Sasia e qumështit në hyrje është më e madhe se 200 tonë/ditë (vlerë mesatare bazuar në të dhëna vjetore).	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 200 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat vjetore), por më shumë se 2 tonë/ditë.	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 2 tonë/ditë ose më pak se kaq.
		f. Trajtim ose magazimin i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve	--------	Të gjitha instalimet	—
		g. Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike	—	Të gjitha instalimet	--------
		h. Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike duke përfshirë fabrikat e birrës		Të gjitha instalimet	--------
		i. Prodhim i produkteve të frutave		Të gjitha instalimet	--------
		j. Prodhim i xhelatinës dhe i materialeve ngjitëse nga lëkurat dhe kockat		Të gjitha instalimet	--------
		k. Prodhimi i produkteve të duhanit	----------	Të gjitha instalimet	----------
		l. Prodhim i ushqimit për kafshë	----------	Të gjitha instalimet	----------
		m. Furra të prodhimit të bukës	----------	----------	Të gjitha instalimet
		n. Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme	---------	----------	Të gjitha instalimet
		o. Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazhuara			Për magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tonë

III.2.10. Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 *"Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta",* parashikohetsi më poshtë:

2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

- Leje Mjedisi e tipit C me kodin III.1.A

- Leje Mjedisi e Tipit B me kodin III.1.B

- Leje Mjedisi e Tipit A me kodin III.1.C

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.12. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proprocion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kritereve të kualifikimin.

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *"2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik"*

III.2.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i

këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.
Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar që *Operatori ekonomik pjesëmarrës, <u>në rast se nuk është thertore</u>, duhet të paraqesë Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A) për magazinimin frigoriferik të produkteve ushqimore të ambalazhuara, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar).* Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konstatohet se për veprimtarinë "Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazhuara, ligjvënëse ka përcaktuar se këto subjekte duhet të pajisjen me leje mjedisore te kategorisë C për magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 ton. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerson se, referuar volumit të furnizimeve të parashikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", si dhe mënyrës së furnizmit të produkteve, të përcaktuara në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, Komisioni gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk janë thertore, duhet të paraqesin Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A) për magazinimin frigoriferik të produkteve ushqimore të ambalazhuara, është një kërkesë e ekzagjeruar e cila nuk është në përpjestim me volumin e parashikuar të furnizimeve objekt kontrate. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter, duke hequr kërkesën për Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A) për magazinimin frigoriferik të produkteve ushqimore të ambalazhuara, për operatorët ekonomikë të cilët nuk janë thertore.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit *"Ne lidhje me kerkesen per Licence te kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", per perpunimin ose tregtimin e produkteve te mishit/ te perpunuara te mishit, ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018). Vleresojme se ne nenin 20 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre. Vleresojme se kriteri i mesiperm perben diskriminim te drejtperdrejte mes furizueve dhe kontraktoreve te tyre duke kerkuar qe nuk lejohet perdorimi I licences se nje operatori ekonomik tjeter. Ne rastin konkret vleresojme se kerkesa e mesiperme nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit. Gjithashtu, kriteri i mesiperm nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit si edhe nuk lidhet drejtperdrejte me objektin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Referuar aktit mbi kthim pergjigje autoriteti kontraktor ka argumentuar se: "Per sa me siper, organi qendror bleres do te publikoje ne sistemin e prokurimit elektonik nje shtojce ku te shtoje ne kriterin e percaktuar ne shtojcen 9, seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" pika 1 edhe licencen II.1.B. Persa*

me siper, pretendimi i ankimuesit "Olta Sharra" PF pranohet dhe ndryshimi i kriterit te behet publik per te gjithe operatoret ekonomik te interesuar me ane te publikimit te nje shtojce ne sistemin e prokurimit elektronik. Ne rastin konkret, sqarojme se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar asnje shtojce dhe se pari nuk eshte e qarte nese do te ndryshohet duke u hequr kerkesa e mesiperme apo duke u shtuar edhe nje kerkese tjeter, Per Licencen II.1.B. Theskojme se kerkesa jone eshte lidhur ngushtesisht me heqjen e Licences se kategorise II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 9, pika 2.1.3, "Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë", është përcaktuar kriteri si më poshtë:

1) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

III.3.2. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", është përcaktuar si më poshtë:

- Për Loti 3 - "Blerje mish dhe nënprodukte të tij për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve"

Nr.	Emërtimi i artikujve ushqimorë	Njësia matëse	Sasitë e pritshme
1	Mish Viçi, cilësi e parë	Kg	359890

III.3.3. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se: *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*: *a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

III.3.4. Në nenin 28 pika 5 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Rregullat e Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

"5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose."

III.3.5. Në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë", Shtojce e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:

Fusha II.

Ushqimi dhe Shëndeti

1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare
III.3.6. Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 *"Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta",* parashikohet:
FUSHA II
USHQIMI DHE SHËNDETI
KATEGORIA II.1
PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE
I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME
1. Veprimtaria e "prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve" është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:
a) "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve", me kodin II.1.A;
b) "Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)", me kodin II.1.B;
c) "Prodhimi primar me shumicë", me kodin II.1.C.
3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.
II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A
5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.
6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:
a) "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", me kodin II.1.A.1.
b) "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim", me kodin II.1.A.2.
c) "Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim", me kodin II.1.A.3.
7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 më poshtë […]
III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.B 1
11. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.B jepen për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së shitjes.
12. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë II.1.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë […].
III.3.7. Autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar: "*Ne shtojcen 9, seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" pika 1 te dokumentave te tenderit percaktohet se, Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes*

Licence te kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.
Kriteri i sipercituar eshte kerkuar ne zbatim te germes "a" pika 1 nenit 46, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku percaktohet se: "1. Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ate Jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata; .. " si dhe referuar Rekomandimit te perbashket Nr.10181 Prot., APP dhe Nr. 8514 Prot., AKU, germa "a" dhe "a.I" e seksionit III "Hartimi i kritereve te vecanta per kualifikim", ku percaktohet se: "Ne hartimin e kritereve te vecanta per kualifikim, autoriteti kontraktor duhet te mbaje ne konsiderate qe: a. Ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje Licence, kategoria II.1A.1 "Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit. a.l. Per te plotesuar kete kriter per kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese licencen kategoria II.1.A.1- "Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez" ne emer te tij, pasi licenca duhet t'i perkase operatorit ekonomik te interesuar te ofertoje per proceduren e prokurimit te shpallur nga autoriteti kontraktor. "
Ne VKM nr.538, date 26.5.2009, Aneksi I, Fusha II "Ushqimi dhe Shendeti", kategoria II.1 "Prodhimi dhe/ose Tregtimi i ushqimeve" ndahet ne disa nenkategori nder te cilat: "Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve", me kodin II.1.A dhe "Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)", me kodin II.l.B. Ne kete VKM parashikohet se Licenca per veprimtarite me kodin II.1.A jepet per cdo stabiliment ku kryhet veprimtaria ndersa Licenca per veprimtarite me kodin II.1.B jepen per cdo vend te ushtrimit te veprimtarise se shitjes. Per sa me siper, organi qendror bleres do te publikoje ne sistemin e prokurimit elektonik nje shtojce ku te shtoje ne kriterin e percaktuar ne shtojcen 9, seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" pika 1 edhe licencen II.1.B. Persa me siper, pretendimii ankimuesit "Olta Sharra" PF pranohet dhe ndryshimi i kriterit te behet publik per te gjithe operatoret ekonomik te interesuar me ane te publikimit te nje shtojce ne sistemin e prokurimit elektronik."
III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos

i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.3.9. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proprocion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kritereve të kualifikimin.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *"2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik"*

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

III.3.12. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Olta Sharra" p.f., për modifikimin e kriterit të mësipërm, duke pranuar se do të shtojë edhe licencen II.1.B.

Megjithatë nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pasqyruar këtë vendim të KSHA në sistemin elektronik, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Për këtë arsye AK duhet të pasqyrojë në SPE vendimin e KSHA lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ky i fundit për modifikimin e kriterit të mësipërm.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, argumentimi i autoritetit si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konstatohet se për veprimtarinë shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz), është i domosdoshëm kodi II.1.B, në proporcion kjo me objektin, llojin dhe specifikat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Pra, sa më sipër argumentuar, konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor se "*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz", për përpunimin ose tregtimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të*

mishit, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)", është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkalim të kontratës objekt prokurimi dhe të dispozitave ligjore përkatëse, duke patur parasysh kushtet dhe specifikat e kryerjes së këtij shërbimi.
Për këtë arsye, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter, duke hequr kërkesën për *Licencë të kategorisë "II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz"* dhe të përcaktojë licencën me kod II.1.B.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit *"Ne lidhje me kerkesen nese operatori ekonomik pjesemarres, ne rast se eshte thertore, duhet te paraqes Leje Mjedisi te tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (sipas ligjit nr. 60/2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit ", te ndryshuar) sqarojme se kerkesa e mesiperme eshte ne kundershtim me nenin nenin 20 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre pasi autoriteti kontraktor po diskriminon ne menyre te drejtperdrejte mes kategorive te operatoreve ekonomike, furnitoreve dhe kontraktoreve te tyre, Akoma me tej, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje qarte natyren e lejes se kerkuar, pasi ne te kundert, shkel nje nder parimet baze te zhvillimit te procedurave ate te trajtimit te barabarte mes kerkesave per operatoret ekonomike sic parashikohet edhe ne nenin 2 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar duke lejuar qe operatore ekonomike te dorezojne dokumentacione te ndryshme dhe te kualifikohen njekohesisht"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 9, pika 2.1.3, "Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë", është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se është thertore, duhet të paraqes Leje Mjedisi të tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar).*

III.4.2. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Loti 3, Shtojca 12 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", është përcaktuar si më poshtë:

- Për Loti 3 - "Blerje mish dhe nënprodukte të tij për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve"

Nr.	Emërtimi i artikujve ushqimorë	Njësia matëse	Sasitë e pritshme
1	Mish Viçi, cilësi e parë	Kg	359890

III.4.3. Në dokumentat e Specifikimet teknike", është përcaktuar si më poshtë:

LOTI 3 - "BLERJE MISH DHE NËNPRODUKTET E TIJ"

3. MISH VIÇI

Bazuar në SSH 1441:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në SSH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre".

Klasifikimi:

- *I freskët, cilësia e parë*

Kërkesat cilësore

Mishi përgatitet në gjysmë trupi dhe në çerek. Trupi ndahet në gjysma në mes të vertebrave të shtyllës kurrizore, duke lënë në njërën anë palcën e kurrizit. Ndarja e gjysmë trupave në çerekë bëhet nëpërmjet brinjës 12 dh 13 dhe nëpërmjet brinjës 7 dhe 8 kur mishi i nënshtrohet ndarjes anatomike. Koka pritet nëpërmjet kockave të qafës dhe të vertebrës së parë të qafës(atlanti) këmbët te kyçet e gjurit, kurse bishti pritet nëpërmjet vertebrës së parë e të dytë të tij. Organet e brendshme, përveç veshkave, veçohen.

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme: Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje. Sipërfaqja e mishit menjëherë pas prerjes është e lagët dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm. Tendinat janë të shëndritshme, elastike dhe të forta. Sipërfaqja e artikulacioneve është e shëndritshme. Lëngu është i tejdukshëm.*
- *Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa qe ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme jo e ngjitshme. Ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.*
- *Era: e këndshme , karakteristikë e llojit.*
- *Palca e kockave : Mbush plotësisht kanalin e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë. Në prerje është e shëndritshme.*
- *Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.*
- *Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.*

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Azot i tretshëm, mg, amoniak (NH_3)/100 gr produkt jo më shumë se 20.*
- *Aciditeti i shprehur në pH: 5.2 deri 6.4.*
- *Reaksioni për hidrogjenin sulfuror (H_2S): Negativ.*
- *Reaksioni Kreis: Negativ.*
- *Ngarkesa mikrobike: Brenda normave te miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.*

Treguesit kimikë dhe mikrobikë analizohen në ato raste kur dyshohet për ndryshime që ka pësuar mishi.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme, këmbë dhe kokë.
Ambalazhimi dhe markimi
Çdo trup, gjysëm trup ose çerek damkoset me vulën e kontrollit veterinar e sanitar dhe me vulën e llojit e të cilësisë së mishit.
Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatën veterinare me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetësore për shitje në treg, për përpunim ose për ruajtje.
Tregtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes.
Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.
Mishi duhet te theret ne ambiente (thertore të licencuara), të cilat plotësojnë standardet higjeno – sanitare dhe veterinare.
Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-ricikluesshme dhe të shoqëruara me çertifikatë konformiteti.
Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.
Ambalazhet duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit.
Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.
Verifikimi i kërkesave cilësore
Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti, e cila përfaqëson sasinë e mishit e të njëjtit lloj i therur në të njëjtën thertore dhe që dorëzohet njëherësh.
Kontrolli veterinar dhe sanitar i mishit bëhet sipas ligjit në fuqi "Mbi shërbimin veterinar".
Mishi të jetë i cilësisë së parë, i shoqëruar me certifikatë veterinare sipas ligjeve ne fuqi.
Të mos ketë përqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.
Mishi i viçit te jete i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri dhe i shoqeruar me Certifikatë Veterinare. Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë certifikatën duhet të jenë të lexueshme mirë. Certifikata veterinare duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuar.
Ruajtja dhe transportimi
Mishi ruhet në kushte frigoriferike.
Në gjendje të ftohur ruhet në temperature nga 0 deri në -1 °C, me lagështirë relative 90-95 %, deri në 10 ditë ose në temperaturën 0 deri në +4 °C deri në 5 ditë. Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore të freskëta dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.
III.4.4. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se: *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*: *a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*
III.4.5. Në nenin 28 pika 5 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Rregullat e Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

”5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose.”

III.4.6. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “*Për Lejet e Mjedisit*”, në nenin 1 dhe 2 “*Qëllimi dhe Objekti*”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.4.7. Në neni 4 “*Sistemi i lejeve të mjedisit*” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “*Për Lejet e Mjedisit*”, parashikohet shprehimisht:

“*1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:*

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji.”

III.4.8. Në shtojcën 1 *“Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”* të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, *“Për Lejet e Mjedisit”*, përcaktohet:

”Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo”.

III.4.9. Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”,* parashikohetsi më poshtë:

2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

- Leje Mjedisi e Tipit C me kodin III.1.A

- Leje Mjedisi e Tipit B me kodin III.1.B

- Leje Mjedisi e Tipit A me kodin III.1.C

III.4.9. Në ligjin Nr. 60/2014 *“Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”*, të ndryshuar, parashikohet:

SHTOJCA 1 LEJET E MJEDISIT TË TIPAVE A, B DHE C NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES KUFI SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT A

Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore	Kapaciteti prodhues i karkasave është më i madh se 50 tonë/ditë	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq, por gjithsesi më shumë se 5 tonë/ditë	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 5 tonë në ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce.	Kapaciteti i trajtimit është më i madh se 10 tonë/ditë të karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë	Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.	--------
		c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 75 tonë në ditë	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 75 tonë në ditë ose më pak se kaq, por më shumë se 5 tonë/ditë	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 5 tonë/ditë ose më pak
		d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 300 tonë në ditë (vlerë mesatare duke u bazuar në të dhëna trimestrale).	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 300 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat trimestrale), por më shumë se 10 tonë/ditë.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak.
		e. Trajtimi dhe përpunimi i qumështit	Sasia e qumështit në hyrje është më e madhe se 200 tonë/ditë (vlerë mesatare bazuar në të dhëna vjetore).	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 200 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat vjetore), por më shumë se 2 tonë/ditë.	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 2 tonë/ditë ose më pak se kaq.
		f. Trajtim ose magazimin i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve	--------	Të gjitha instalimet	—
		g. Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike	—	Të gjitha instalimet	-------
		h. Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike duke përfshirë fabrikat e birrës		Të gjitha instalimet	-------
		i. Prodhim i produkteve të frutave		Të gjitha instalimet	-------
		j. Prodhim i xhelatinës dhe i materialeve ngjitëse nga lëkurat dhe kockat		Të gjitha instalimet	-------
		k. Prodhimi i produkteve të duhanit	----------	Të gjitha instalimet	----------
		l. Prodhim i ushqimit për kafshë	----------	Të gjitha instalimet	----------
		m. Furra të prodhimit të bukës	----------	----------	Të gjitha instalimet
		n. Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme	---------	----------	Të gjitha instalimet
		o. Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazhuara			Për magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tonë

III.4.10. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë

kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.4.11. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proprocion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kritereve të kualifikimin.

III.4.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *"2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik"*

III.4.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar që *Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se është thertore, duhet të paraqes Leje Mjedisi të tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar)*. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konstatohet se për veprimtarinë "Thertore", ligjvënësi ka përcaktuar se këto subjekte duhet të pajisjen me leje mjedisore te kategorisë A, B, C sipas kapacitet prodhues përkatës.

Sa me sipër, KPP gjykon se, kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në rast se janë thertore, duhet të paraqesin Leje Mjedisi të tipit A ose tipit B ose tipit C (kodi III.1.C ose III.1.B ose III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të

ndryshuar), është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore si të Ligjit Nr. 60/2014 *"Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit"*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Olta Sharra" p.f. për procedurën e prokurimit *"E hapur, mbi kufirin e lartë",* me nr. *REF-53912-03-11-2020,* me objekt: Loti 3*"Blerje mish dhe nënproduktet e tij për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjve"*, me fond limit 287.712.061 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 27.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Olta Sharra" p.f.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 333 Protokolli,
Datë 03.04.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	**Vilma Zhupaj**	**Lindita Skeja**	**Merita Zeqaj**

Kryetar
Evis Shurdha